

# Projektet e HEC-eve brenda Zonave të Mbrojtura në Ballkan

## Përmbledhje

Ky studim vlerëson numrin e projekteve të hidrocentraleve që janë planifikuar brenda zonave të mbrojtura në Gadishullin Ballkanik. Një total prej 1640 hidrocentralesh të projektuara, janë shqyrtuar bazuar në një rrjet të detajuar dhe të kategorizuar të zonave të mbrojtura. Baza e të dhënave në fakt përshin hidrocentralet me kapacitet më të madh se 1 MW, por për parqet kombëtare specifike dhe zonat e fushatës si (PK Mavrovë në Maqedoni, PK në Shqipëri si edhe habitatet e salmonit të Danubit në pellgun lumit Sava dhe Serbi), janë marrë në konsideratë edhe HEC-et e vegjël.

51 Parqe Kombëtare dhe 64 Zona Ramsar / Rezervat të Biosferës / Zona të Trashëgimisë Natyrore Botërore janë marrë në konsideratë në të gjithë zonën e studimit. I kombinuar me zona *Natura 2000* në SI / HR / BG dhe GR dhe rezervateve kombëtare strikt të mbrojtura në vendet jo-anëtare të BE-së, rajoni përmban një rrjet mjaft të dendur të zonave të mbrojtura. Megjithatë, në BA, RS, ME, KV, MK dhe AL shumë zona nuk janë të mbrojtura në mënyrën e duhur. Në disa raste përcaktimi dhe dizenjimi i zonave Emerald është kryer në mënyrë të paqartë ose ende nuk është përfunduar.

Zonat e mbrojtura janë kategorizuar në pesë grupe ku në secilin prej tyre janë bashkëngjitur të dhënat për hidrocentralet. Disa projekte HEC-esh përfshihen në më shumë se një kategori, megjithatë, në rezultatet e përgjithshme, është eliminuar numërimi i dyfishtë ("më tepër në"), në mënyrë që projektet e HEC-eve të numërohen vetëm në kategorinë me nivel më të lartë të mbrojtjes. Rezultatet janë si më poshtë:

1. Park Kombëtar: 113 (7%), më tepër në
2. Ramsar/RB/ZTNB: 23 (1%), më tepër në
3. Natura 2000: 131 (8%), më tepër në
4. Rezervat Natyror Strikt: 268 (16%), më tepër në
5. Të tjera Zona të Mbrojtura: 282 (17%).

**Një total prej 535 projekteve të planifikuara, ose 32% ndodhen në zonat strikt të mbrojtura.** Përveç kësaj, 282 HEC-et (17%) janë parashikuar brenda zonave të tjera të mbrojtura me një status më të ulët të mbrojtjes. **Gjithsej, 817 ose 49% e të gjithë projekteve të planifikuara të HEC-eve në lumenjtë e Ballkanit, përfshihen brenda zonave të mbrojtura.**

**Rezultatet tregojnë për një presion shumë të lartë të HEC-eve në Zonat e Mbrojtura.** Ndërtimi i hidrocentraleve brenda zonave strikt të mbrojtura në shumicën e rasteve nuk përbën përjashtim por përkundrazi përbën një rregull. Nga ana tjetër duhet theksuar se në zonat me statusin më të lartë të mbrojtjes edhe hidrocentralet e vegjël nuk janë të pranueshëm si një zgjidhje e qëndrueshme.